



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
Komuna Kaçanik
Opstina Kaçanik – Municipality Kaçanik



Kuvendi i Komunës
01Nr.104/02-18514/23

Kaçanik,31.07.2023

Në mbështetje të nenit 58, pika (h), nenit 12 të Ligjit nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, të nenit 6, pika (b) dhe (h), të Statutit të Komunës së Kaçanikut, të nenit 5, 6 pika 1.2 dhe të nenit 14 të Ligjit Nr. 06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, të nenit 4, paragrafi 1.3 të Rregullores (QRK) – Nr.09/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, Vendimit për aprovimin e listës së veçantë të pronave komunale të cilat planifikohen të jepen në shfrytëzim në vitin 2023, me nr. 01Nr.I04/02-3282/22 të datës 29.12.2022, në bazë të kërkesës së MAPL-së, të datës 28.07.2023 për rishqyrtimin e ligjshmërisë së Vendimit, të Propozimit vendimit të Kryetarit të Komunës, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur më 31.07.2023, merr këtë:


VENDIM

PËR NDRYSHIM PLOTSIMIN E VENDIMIT PARAPRAK 01NR.104/02-13790/23, TË DATËS 30.06.2023 PËR DHËNIEN E PRONËS SË PALUAJTSHME TË KOMUNËS NË SHFRYTËZIM AFATGJATË DHE AFATSHKURTER

1. Me këtë Vendim ndryshohet dhe plotësohet Vendimi i Kuvendit të Komunës **01nr.104/02-13790/23, të datës 30.06.2023**
2. Ndryshim plotësimi i Vendimit të përcaktuar si në pikën 1 të këtij Vendimi bëhet në pikën 1, 4, 5 dhe pika 6, ashtu që:
 - 2.1. Te pika 1 hiqet afati i shfrytëzimit të pronës komunale në shfrytëzim afatshkurtër
 - 2.2. Te pika 4 dhe pika 5 hiqen tërësisht
 - 2.3. Te pika 6 ndryshohet dhe hiqet pika 4.1. që ka të bëjë me dhënien e pronës në shfrytëzim afatshkurtër .
3. Pjesa tjetër e vendimit mbetet e pandryshuar.
4. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të MAPL-së, si dhe 7 ditë pas publikimit në web faqen zyrtare të komunës.
5. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset : Kryetari i komunës , Drejtoria për Urbanizëm ,Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa.

Me këtë Vendim njoftohen: Kryetari i komunës, Drejtoria për Urbanizëm ,Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit , Drejtoria për Buxhet dhe Financa dhe Arkivi.





Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Për:	Besim Ilazi, Kryetar i Komunës së Kaçanikut Kemal Murseli, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Kaçanikut
Kopje:	Njësisë për Administrimin e Dokumenteve në MAPL Njësisë për Administrimin e Dokumenteve në Komunë
Përmes:	Elbert Krasniqi, Ministër i MAPL-së Trim Berisha, Zv. Sekretar i Përgjithshëm i MAPL-së
Nga:	Besim Myrtezani, Zv. Udhëheqës i Departamentit Ligjor dhe Monitorimit të Komunave, MAPL Datë: 17.07.2023 Nr: VI-020-576
Zyrtaret përgjegjës:	Xhevat Tafa, Udhëheqës i Divizionit për Monitorim të Komunave Vjosa Ahmetaj, Zyrtare e Lartë për Monitorim të Komunave
Lënda:	Kërkesë për rishqyrtim të ligjshmërisë së aktit të Komunës së Kaçanikut
Lloji i aktit:	Vendim

I nderuar Kryetar,
I nderuar Kryesues,

Në pajtim me Rregulloren e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, si dhe Rregulloren nr. 06/2021 për ndryshimplotësimin e Rregullores (QRK) Nr. 10/2019, për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, e në bazë të kompetencave ligjore të ministrisë të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren e Qeverisë Nr. 02/2021 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Departamenti Ligjor dhe Monitorim të Komunave i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale aktin komunal në vijim:

Vendimin 01 Nr. 104/02-13788/23 për formimin e komisionit vlerësues për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës

E miratuar më datë: 30.06.2023

E parashtruar për shqyrtim në MAPL më datë: 06.07.2023

Ministria e Pushtetit Lokal, pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të komunës si më sipër, vlerëson së akti i komunës është në kundërshtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi.

Arsyetim

Kuveridi i Komunës së Kaçanikut në mbledhjen e mbajtur me datë 30.06.2023, ka miratuar Vendimin 01Nr. 104/02-13790/23 paraparak për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim afatgjatë dhe afatshkurtër.

Vendimi i nxjerrë nga Kuvendi i Komunës së Kaçanikut është në kundërshtim me Ligjin 06/L-092 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, përkatësisht Rregulloren (QRK) Nr. 09/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, nenin 8 ku përcaktohet dhënia në shfrytëzim afatshkurtër e pronës së paluajtshme të komunës që bëhet përmes ankandit publik dhe nenin 13 ku përcaktohet dhënia në shfrytëzim afatgjatë e pronës së paluajtshme të Komunës që bëhet përmes shprehjes së interesit.

Vendimi 01Nr. 104/02-13790/23 paraparak për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim afatgjatë dhe afatshkurtër, duhet ndarë në dy vendime paraprase një për dhënien e pronës në shfrytëzim afatgjatë dhe tjetri për dhënien të pronës në shfrytëzim afatshkurtër sepse sipas legjislacionit në fuqi kemi të bëjmë me dy procedura të ndryshme.

Bazuar në të lartcekurat Kuvendi i Komunës së Kaçanikut duhet të ndërmer veprime dhe brenda afatit ligjor të rishqyrtoj aktin dhe të harmonizoj më legjislacionin në fuqi.

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, mbetet në dispozicion të komunës për çfarëdo sqarimi të mëtejshëm lidhur me këtë vlerësim.



01Nr. 104/02-13790/23
Kaçanik, 30.06.2023

Në mbështetje të nenit 12.2 (d) lidhur me nenin 14 dhe 17 të ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare Nr. 28/4 Qershor 2008) të nenit 5 dhe 6 pika 1.2, 14.3 të Ligjit Nr. 06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës / Nr. 10 / 03 prill 2019), të nenit 4, 5 pika 1.3 të Rregullores (QRK) – Nr.09/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, të nenin 6 pika (b) dhe (h) të Statutit të Komunës së Kaçanikut, të Vendimit për aprovimin e listës së veçantë të pronave komunale të cilat planifikohen të jepen në shfrytëzim në vitin 2023, me nr. 01Nr.104/02-3282/22 të datës 29.12.2022, duke vendosur sipas Kryetari i Komunës nëpërmjet Drejtorisë për Urbanizëm, Kadaster dhe Mbrojtjes së Mjedisit, Kuvendi i Komunës Kaçanik në mbledhjen e mbajtur me 30 qershor 2023, mori këtë:

**VENDIM PARAPRAK
PËR DHËNIEN E PRONËS SË PALUAJTSHME TË KOMUNËS
NË SHFRYTËZIM AFATGJATË DHE AFATSHKURTËR**

1. Me këtë Vendim fillon procedura nga komisioni vlerësues për Dhënien në Shfrytëzim AFATGJATË DHE AFATSHKURTËR, për pronat e paluajtshme të Komunës së Kaçanikut, personave fizik dhe juridik.
2. Pronat e paluajtshme për dhënie në shfrytëzim të cekura si në pikën 1. të këtij Vendimi, për dhënie në shfrytëzim në periudhë afatgjatë kohore janë:
 - 2.1 Njësia Kadastrale me nr. **P-70917026-00143-2**, me kulturë kullosë e klasës 4, me sipërfaqe prej 01.50.01 ha, Zona Kadastrale **Doganaj** (Rregulluar dhe e ndarë nga parcela P-70917026-00143-1).
 - 2.2 Njësia Kadastrale me nr. **P-70917026-00143-4**, me kulturë kullosë e klasës 4, me sipërfaqe prej 01.00.00 ha, Zona Kadastrale **Doganaj**. (Rregulluar dhe e ndarë nga parcela P-70917026-00143-1).
 - 2.3 Njësia Kadastrale me nr. **P-70917026-00143-5**, me kulturë kullosë e klasës 4, me sipërfaqe prej 00.87.77 ha, Zona Kadastrale **Doganaj** (Rregulluar dhe e ndarë nga parcela P-70917026-00143-1).
 - 2.4 Njësia Kadastrale me nr. **P-70917093-00156-5**, me kulturë kullosë e klasës 4, me sipërfaqe prej 00.50.10 ha, Zona Kadastrale **Koxhaj**. (Rregulluar dhe e ndarë nga parcela P-70917093-00156-2).
 - 2.5 Njësia Kadastrale me nr. **P-70917093-00156-7**, me kulturë kullosë e klasës 3 dhe 4, me sipërfaqe prej 00.55.00 ha, Zona Kadastrale **Koxhaj**. (Rregulluar dhe e ndarë nga parcela P-70917093-00156-1).
 - 2.6 Njësia Kadastrale me nr. **P-70917093-00156-8**, me kulturë kullosë e klasës 3, me sipërfaqe prej 00.55.00 ha, Zona Kadastrale **Koxhaj**. (Rregulluar dhe e ndarë nga parcela P-70917093-00156-1).
 - 2.7 Njësia Kadastrale me nr. **P-70917003-02706-3**, me kulturë kullosë e klasës 3, me sipërfaqe prej 02.09.05 ha, Zona Kadastrale **Begracë**.

2.8 Njësia Kadastrale me nr. **P-70917003-02706-5**, me kulturë kullosë e klasës 0, me sipërfaqe prej 00.61.42 ha, Zona Kadastrale **Begracë**.

3. Pronat e propozuara në pikën **2.1, 2.2, 2.3, 2.4, 2.5, 2.6, 2.7, 2.8**, të epën në shfrytëzim për periudhën afatgjate për **nëntëdhjetenëntë (99) vite**, përmes procedurës së Shprehjes së Interesit ku bëhet përzgjedhja e ofertave nga ana e Komisionit Vlerësues i formuar me vendim të veçantë të Kuvendit të Komunës.
4. Pronat e paluajtshme për dhënie në shfrytëzim të cekura si në pikën 1. të këtij Vendimi, për dhënie në shfrytëzim në periudhë afatshkurtër, kohore janë:
 - 4.1 Njësia Kadastrale me nr. **P-70917048-00005-2**, me kulturë kullosë e klasës 4, me sipërfaqe prej 00.40.08 ha, Zona Kadastrale **Kaçanik**. (Rregulluar dhe e ndarë nga parcela P-70917048-00005-0).
5. Pronat e propozuara në pikën **4.1**, të epën në shfrytëzim për periudhën afatshkurtër **pesëmbëdhjetë (15) vite**, përmes procedurës së Ankandit Publik, ku bëhet përzgjedhja e ofertave nga ana e Komisionit Vlerësues i cili do të formohet me vendim të veçantë nga ana e Kuvendit Komunal.
6. Pronat e përcaktuara në njësitë kadastrale të pikave: **2.1, 2.2, 2.3, 2.4, 2.5, 2.6, 2.7, 2.8**, dhe **4.1**, të këtij Vendimi, janë prona të Komunës së Kaçanikut dhe Pronat e propozuara për dhënien në shfrytëzim nuk kanë kontest pronësor me asnjë palë, janë në pajtueshmëri me dokumentet e planifikimit hapësinor, shfrytëzimi i tyre bazohet në ruajtjen dhe garantimin e interesit publik, ruajtjen e mjedisit dhe rritjen e vlerës së pronës publike komunale
7. Procedurat e parapara me Ligjin Nr. 06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës dhe me Rregullores (QRK) – Nr.09/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës do t'i zhvilloi, Komisioni Vlerësues për dhënien në shfrytëzim pronën e paluajtshme të komunës, i formuar me Vendim të Kuvendit të Komunës.
8. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset, Kryetari i Komunës.
9. Ky Vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të autoritetit mbikëqyrës – MAPL-së, si dhe 7 ditë pas publikimit në Faqen zyrtare të komunës.

Vendimi iu dërgohet: MAPL; Komisionit vlerësues; Kryetarit të Komunës; DUKMM; DZHET; Arkivit.

Kryesuesi i Kuvendit
Kemal Murseli

